



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**BASHKIA KORÇË**

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE DHE E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE**

**KORÇË MË \_\_\_\_/\_\_\_\_/2023**

**RELACION**

**“PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMI NR.25 DATË 28.02.2019 PËR DHËNIEN E  
PËLQIMIT PËR PRIVATIZIMIN E OBJEKTIT TË ISH NDËRMARRJES SË  
GRUMBULLIMIT TË DRITHIT”**

Me Vendim nr.25 datë 28.02.2019 Këshilli Bashkiak Korçë ka miratuar dhënie e dakordësisë për privatizimin e objektit të Ish Ndërmarrjes së Grumbullimit të Drithit Korçë, pasuri me nr.3/716 vol.33 fq.122 ndërtesë me sipërfaqe 2860 m2 ZK 8564 me adrese Rruga Petraq Shomo.

Ky vendim, shoqëruar me konfirmimin e bazueshmerisë ligjore nga ana e Prefektit të Qarkut Korçë, i është dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtorisë së Privatizimit.

Me shkresë të datës 02.12.2022 protokolluar pranë Bashkisë Korçë me nr.10470 Prot. datë 05.12.2022, Ministria e Financave dhe Ekonomisë i ka kërkuar Bashkisë Korçë informacion të detajuar mbi objektet që përfshihen në këtë procedurë privatizimi. Kjo pas pretendimeve të anëtarëve të familjes Nene, përfitues të së drejtës së parablerjes mbi këto pasuri, referuar Vendimit të Gjykatës nr.3026 datë 01.12.1995 regjistruar në regjistrat hipotekorë. Trashëgimtarët e familjes Nene kanë privatizuar në vitin 1996 objektin “Fabrika e Çembrionizimit”, objekti nr.9, sipas skicës nr.2 pjesë e Vendimit të Gjykatës nr.3026 datë 01.12.1995. Sipas kontratës së shitjes të datës 18.09.1996 dhe aktit të dorëzimit të po të njëjtës datë, referuar mandat arkëtimeve për likuidimin e vlerës së objektit dhe autorizimit për blerje objekti të datës 28.08.1996, “Fabrika e Çembrionizimit” me sipërfaqe 4646 m2, sipas genplanit bashkangjitur kontratës së shitjes, është privatizuar nga pala blerëse Jovan Blushi, Pandush Face, Kristaq Kafexhi, Safer Zemblaku dhe Klotilda Buri. Si rrjedhojë, ky objekt nuk duhet të përfshihet në Vendimi nr.25 datë 28.02.2019 i Këshillit Bashkiak Korçë.

Referuar informacionit nga ASHK, Drejtoria Vendore Korçë mbi pasurinë 3/716 ZK 8561, në bazë të Vendimit të Gjykatës nr.3026 datë 01.12.1995 hipotekuar në nr.763/9 datë 05.01.1996 është regjistruar e drejta e parablerjes për:

- Objektin nr.1
- Objektin nr.3
- Objektin nr.4
- Objektin nr.5
- Objektin nr.6
- Objektin nr.7
- Objektin nr.8 për 90 m2
- Objektin nr.9 për sipërfaqen 437 m2
- Objektin nr.10
- Objektin nr.11
- Objektin nr.12

Identifikimi i këtyre objekteve kryhet sipas skicave nr.1 dhe 2 bashkangjitur vendimit të regjistruar në hipotekë. Kërkesa për privatizim nga ana e përfaqësuesve të familjes Nene mbulon objektet si më poshtë:

- Objekti nr.5 (Zyrat e Ndërrmarjes); Nr.pasurie 3/715 ZK 8561 me sipërfaqe 198 m2
- Objekti nr.6 (Depo e Miellit); Nr.pasurie 3/716 ZK 8561 me sipërfaqe 994.5 m2
- Objekti nr.7 (Depo); Nr.pasurie 3/716 ZK 8561 me sipërfaqe 590 m2
- Objekti nr.8 (Ish fabrika e Miellit); Nr.pasurie 3/716 ZK 8561 me sipërfaqe 90 m2

Si rrjedhojë, pas kërkesës së Drejtorisë së Privatizimit pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për emërtimin e objekteve për të cilët do të vijojë procedura e privatizimit, kërkojmë nga ana e Këshillit Bashkiak Korçë të miratojë ndryshimin e Vendimit nr.25 datë 28.02.2019 duke përfshirë objektin nr. 9 “Fabrikën e Çembrionizimit” dhe duke përfshirë në këtë vendim objektet si më poshtë, referuar genplanit bashkangjitur ketij relacioni:

- Objekti nr.5 (Zyrat e Ndërrmarjes); Nr.pasurie 3/715 ZK 8561 me sipërfaqe 198 m2
- Objekti nr.6 (Depo e Miellit); Nr.pasurie 3/716 ZK 8561 me sipërfaqe 994.5 m2
- Objekti nr.7 (Depo); Nr.pasurie 3/716 ZK 8561 me sipërfaqe 590 m2
- Objekti nr.8 (Ish fabrika e Miellit); Nr.pasurie 3/716 ZK 8561 me sipërfaqe 90 m2

Bazuar në VKM Nr.926 datë 29.12.2014 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet, dhe procedurën e shitjes” i ndryshuar, në ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 54 gërma e) ***i kërkohet Këshillit të Bashkisë Korçë të miratojë ndryshimin e Vendimit nr.25 datë 28.02.2019 “Për dhënien e pëlqimit për privatizimin e objektit të Ish ndërmarjes së Grumbullimit të Drithit” duke përfshirë në privatizim objektet e mëposhtme:***

- Objekti nr.5 (Zyrat e Ndërrmarjes); Nr.pasurie 3/715 ZK 8561 me sipërfaqe 198 m2
- Objekti nr.6 (Depo e Miellit); Nr.pasurie 3/716 ZK 8561 me sipërfaqe 994.5 m2
- Objekti nr.7 (Depo); Nr.pasurie 3/716 ZK 8561 me sipërfaqe 590 m2
- Objekti nr.8 (Ish fabrika e Miellit); Nr.pasurie 3/716 ZK 8561 me sipërfaqe 90 m2

***sipas genplanit bashkangjitur.***

Dokumente bashkangjitur këtij relacioni:

1. Vendim nr.25 datë 28.02.2019 shoqëruar me genplan.
2. Shkresë e Ministrisë së Financave nr.10470 prot. datë 05.12.2022.

3. Skica nr.1 dhe 2 pjesë e Vendimit të Gjykatës.
4. Informacion nga ASHK, Korçë në lidhje me pasurinë 3/716 ZK 8561 + Kartelë pasurie + Fragment harte kadastrale.
5. Kontratë shitje objekti Fabrika e Çembrionizimit datë 18.09.1996 + Autorizim për blerje objekti + Mandat këtime + Akt dorëzimi + Genplan objekti.
6. Genplan bashkë jetë turketijë relacioni me emërtimet e objekteve të përfshira në privatizim.

**Drejtores e Përgjithshme**

**Anxhela (Dishnica) Qeramixhi Zhaneta Lubonja**

**Drejtores e DPKZHT**

**KRYETARI**

**Sotiraq FILO**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KORÇË**

**KËSHILLI BASHKIAK**

**P/V E N D I M**

Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_ 2023

**'PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMI NR.25 DATË 28.02.2019 PËR DHËNIEN E  
PËLQIMIT PËR PRIVATIZIMIN E OBJEKTIT TË ISH NDËRMARRJES SË  
GRUMBULLIMIT TË DRITHIT”**

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori nëshqyrtimrelacionin e paraqitur nga Drejtoria Juridike, bazuar në dispozitat e VKM-se Nr.926 datë 29.12.2014 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet, dhe procedurën e shitjes” i ndryshuar, në ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 54 gërma e) :

**KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D O S I**

1. Miratimin e ndryshimit të Vendimit nr.25 datë 28.02.2019 “Për dhënien e pëlqimit për privatizimin e objektit të Ish Ndërmarrjes së Grumbullimit të Drithit”.
2. Objekti nr.9 (Fabrika e Çembrionizimit) nuk përfshihet në këtë vendim për dhënien e pëlqimit për privatizim.
3. Përfshihen në privatizim objektet identifikuar sipas genplanit bashkangjitur këtij vendimi, me emërtime si më poshtë:
  - Objekti nr.5 (Zyrat e Ndërmarrjes); Nr.pasurie 3/715 ZK 8561
  - Objekti nr.6 (Depo e Miellit); Nr.pasurie 3/716 ZK 8561
  - Objekti nr.7 (Depo); Nr.pasurie 3/716 ZK 8561
  - Objekti nr.8 (Ish fabrika e Miellit); Nr.pasurie 3/716 ZK 8561

4. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike(*sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”*).

Sekretari i Këshillit Bashkiak **K R Y E T A R**

**Eva NAÇI**

**Erjon NEXHIPI**

Miratuar me \_\_\_\_\_vota

Vota Pro \_\_\_\_\_

Vota Kundër \_\_\_\_\_

Vota Abstenim \_\_\_\_\_

Zbardhur më datë \_\_\_\_\_